



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1016 Prot.
15

Patos, më 24/04/2026

PROCESVERBALI I TAKIMIT 24 PRILL 2026

Vendi: Njësia administrative Ruzhdie

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 11:00

Dëgjesë publike me temë: "Marrja e kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2027-2029".

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", si dhe VKB nr. 83, datë 17.12.2025 "Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2027-2029 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2027".

Pjesëmarrës: Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Sekretare e Përgjithshme znj. Juela Shpata, Drejtore e Financave znj. Mimoza Shtëmbari, Anëtarë GMS, përfaqësues të bashkisë Patos, me pjesëmarrjen e **17 pjesëmarrësve** (banorë, përfaqësues të shoqatave dhe shoqërisë civile, kryetarë të fshatrave etj)

Takimin hapet nga sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba

Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba- Të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë



**Sekretere e Këshillit
Znj. Refaela Xeba**

**Dëgjesë publike me temë:
"Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029".**

Prill 2026

pjesë të kësaj dëgjese publike. Tema e kësaj dëgjese është “Marrja e kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2027-2029”. Kjo dëgjese është e bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 83, datë 17.12.2025 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2027-2029 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2027”. Jemi në hapat e parë të procedurës për hartimin e PBA-së dhe presim kërkesat tuaja. Do ju lutesha që fjala të merrej me rradhë dhe të prezantoheshit gjatë kërkesave tuaja. Ju faleminderit!

Drejtoresha e Financave, znj. Mimoza Shtëmbari – Përshëndetje të gjithëve! Ne jemi mbledhur sot për të marrë të gjitha kërkesat tuaja që mund të keni lidhur me PBA-në 2027-2029. Këto kërkesa do të pasqyrohen në buxhet për tre vitet e ardhshme.



**Drejtoresha e Financave
znj. Mimoza Shtëmbari**

**Dëgjese publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**


Kryetari i fshatit Gjynoqarë, z. Nuri Gllava – Përshëndetje! Në fshatin tonë rruga e Gjynoqarës po vazhdon, ujësjellsi gjithashtu po vazhdon. Kërkesë kam për disa malore në fshatin tonë për çakull dhe ndonjë rrugë sabio sepse dhe çakull duhet të stabilizohet. Duhet edhe kosha mbeturinash në fshatin tonë. Kemi një fushë sporti që e kanë mbushur plot me mbeturina dhe duhet pastruar. Rrugët e parcelave duhet të vazhdojnë akoma të hapen siç është Mashkullorja dhe një pjesë në Gjynoqarë.



**Kryetari i fshatit Gjynoqarë
z. Nuri Gllava**

**Dëgjese publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

Kryetar i fshatit Siqecë, z. Myftar Sorraj– Përshëndetje! Ne kemi një problem shumë emergjent që është uji i pijshëm. Në fshatin tonë duhet të ketë patjetër ujë të pijshëm sidomos tani që po afron dhe vera. Uji është shtrir në vetëm 30% të fshatit, 70% është pa ujë. Kemi problem me koshat e mbeturinash, nuk kemi kosha. Gjithashtu na duhen disa tumbino për tu vendosur në lumin që kemi që familjet të shkojnë në tokat e tyre. Janë diku te 15 familje që nuk shkojnë dot në tokë. Kemi problem me ndriçimin në Siqecë, i cili është lënë gjysëm. Kemi problem edhe me rrugën pasi nga shirat ka shkarë dhe një pjesë, duhen pastruar dhe ndërhyrë. Gjithashtu rruga Malaj duhet shtruar pasi është në gjendje të keqe dhe dueht bërë me beton.



**Kryetar i fshatit Siqecë
z. Myftar Sorraj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

Drejtoresh e Emergjencave Civile dhe Zhvillimit të Territorit, z. Boreta Murati- Për sa i



**Drejtoresh
z. Boreta Murati
Dëgjesë publike me temë:**

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

përket projekteve të ujësjellsit Siqeca nuk është pjesë e këtyre projekteve që janë duke u zbatuar. Duhet të presim nëse do të jetë pjesë e Lot 4 të ujësjellsit fshati juaj i përfshirë. Mendohet që në këtë LOT të përfshihen të gjithë fshatrat që nuk janë përfshirë.

Kryetar i fshatit Kasnicë, z. Haxhi Qosanj- Në fshatin tonë është shtruar një rrugë dhe nga asfalti deri në Oficinë të vjetër ka mbetur rruga pa shtruar rreth 350 m, nga ura deri te asfalti te rruga kryesore. Ajo pjesë rruge na përket bashkisë tonë, por është në kufi. Aty në atë rrugë kalon i gjithë fshati. Është në gjendje të keqe si rrugë dhe kalojnë makina të tonazhit të rëndë

duke e shkatërruar si rrugë dhe dëmtuar. Edhe asfalti që shtruat ju do priset nga pesha e makinave të rënda që kalojnë. Gjithashtu edhe te pjesa e rrugës nga mbaron asfalti dhe deri te lagjja lart, rruga është prishur e gjithë dhe duhet karikuar edhe ajo pjesë me rërë bituminoze. Është lagjja Qosaj dhe Hoxhaj lart në Kasnicë. Duhet edhe ndriçim te rruga që keni shtruar me asfalto beton dhe kanalizime sepse do gërryhet nga uji. Duhet bërë edhe me asfalto beton ajo pjesë.




**Kryetar i fshatit Kasnicë
z. Haxhi Qosanj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.**

Prill 2026

Drejtoreshë, znj. Boreta Murati- Për pjesën e mjeteve me tonazh të rënd do të shikojmë mundësinë që të reduktojmë kalimin e tyre në fasha orare të kufizuara në mënyrë që të lehtësojmë problemin e ngritur.



**Drejtoreshë
znj. Boreta Murati**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.**

Prill 2026

Kryetar i fshatit Ruzhdie, z. Sako Myftaraj- Për sa i përket traktorit në fshatin tonë nuk është hapur asnjë rrugë parcele, vetëm dy familje. Iku traktori nga Ruzhdia dhe i la gjysëm. Kemi një rrugë këtu në lagje në Ruzhdie dhe është lënë gjysëm, nuk i është hedhur akoma betoni. Bëhet fjalë për rrugën Myftaraj që duhet bërë me asfalt.



**Kryetar i fshatit Ruzhdie
z. Sako Myftaraj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.**

Prill 2026

Drejtoreshë, znj. Boreta Murati- Rruga Myftaraj do shtrohet me asfalto beton deri te sheshi, pjesa tjetër do bëhet me beton më vonë. Ne jemi duke punuar paralelisht në disa rrugë dhe do vijmë nga Siqeca për në Patos dhe do bëhen paralelisht të gjitha sipas grafikut.



**Drejtoreshë
znj. Boreta Murati**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.**

Prill 2026

Kryetar i fshatit Drenie, z. Shaban Lazaj- Përshëndetje! Pjesa e rrugës nga urat e Siqecës deri të Mekani do makinë me rërë bituminoze sepse është me gropa. Segmenti tjetër nga Mekani deri te varrezat e bllokut u zgjerua dhe komuniteti është i kënqaur. Segmenti nga Mekani drejt fshatit la nevojë për rërë bituminoze dhe riparim. Drenia ka dhe një rrugë që del



**Kryetar i fshatit Drenie
z. Shaban Lazaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.**

Prill 2026

nga Ballshi, nga lagjja sipër deri në Lofkënd, rruga e pyllit që quhet dhe ka nevojë për çakull. Një problem tjetër kemi me pyllin e Drenies pasi nuk ka rrugë të shtruara me çakull në pyllin

tonë për të kaluar në rast të zjarreve dhe duhet shtruar me çakull në mënyrë që të kalohet. Kam dhe një problem në drejtim të elektrikut pasi shtyllat kapin në pemë dhe duhen rregulluar.

Drejtoreshë, znj. Boreta Murati- Ne do i bëjmë një njoftim OSHEE lidhur me problemin e shtyllave në mënyrë që të marrin masa.



**Drejtoreshë
znj. Boreta Murati**

**Dëgjuesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.**

Prill 2026

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba